Nr. 2293 Prot. **Tiranë më 20/05/2026**

Lënda: **Njoftim**
Mbi njoftimin e zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë SiCRED sh.a.

Për: **BFSE HOLDING B.V.**
z. Aleksander PILO
znj. Emi SANTO
z. Egi SANTO
z. Petraq SHOMO
z. Arben TAIPI
z. Artan XHORI
z. Kristino KROMIDHA

Të nderuar aksionarë të shoqërisë SiCRED sh.a.,

Bazuar në Statutin e shoqërisë SiCRED sh.a., si dhe neneve 137, 139 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008,"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (i ndryshuar), depozitoj në vëmendjen tuaj, kërkesën për zhvillimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Aksionareve të shoqërisë SiCRED sh.a., me rend dite të listuar si vijon:

1. "Mbi njohjen, përzgjedhjen dhe miratimin e kompanisë audituese (nën cilësinë e auditit të pavarur edhe të ekspertit kontabël të autorizuar) për auditimin e pasqyrave financiare individuale të shoqërisë së sigurimit të jetës SiCRED sh.a., si dhe ato të konsoliduara të grupit ekonomik SiCRED sh.a., për vitet 2026, 2027, 2028, 2029 të shoqërisë SiCRED sh.a.,", sipas tekstit bashkëlidhur.
2. "Mbi njohjen edhe miratimin e pasqyrave financiare te veçanta dhe te konsoliduara, te vitit te mbyllur ne 31-12-2025 te shoqërisë SiCRED sh.a.", sipas tekstit bashkëlidhur.
3. "Mbi njohjen, miratimin e rezultatit, si dhe destinimin e fitimit për vitin te mbyllur me 31-12-2025, të Shoqërisë "SiCRED" sh.a.,", sipas tekstit bashkëlidhur.
4. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.

Sqarojmë se referuar ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 (i ndryshuar), gëzoni:

- të drejtën e përfaqësimit në Asamblenë e Përgjithshme, edhe nëpërmjet një autorizimi përfaqësimi, lëshuar për një aksionar tjetër apo person të tretë, vetëm për rendin e ditës të sipërcituar, njoftuar n.p.m., kësaj shkrese; si dhe
- procedura e votimit mund të kryet me votim personal apo me votim me shkresë (*kur jemi para votimit të autorizuar me shkresë, akt i cili duhet të posedohet në origjinal nga përfaqësuesi i autorizuar, ditën e zhvillimit të mbledhjes së njoftuar*), sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Ju lutemi gjeni bashkëlidhur dokumentacionin për të gjitha pikat e rendit të ditës. Mbledhja zhvillohet me datë 11-06-2026, vendi "SiCRED sh.a.", Tiranë, ora 17:30.

Me respekt

Genc KOXHAJ
Drejtor i Përgjithshëm

SiCRED sh.a.
Shoqëri Sigurimi Jete
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5,
Rr. "Brigada VIII", Vila nr. 3/1, Tiranë.
Tel: +355 4 22 37 549,
Fax: +355 4 22 37 530
Cel: +355 (0) 69 20 84 026
Web: www.sicred.com.al